

KOALICIONI I EUROPES JUGLINDORE PËR MBROJTJEN E BILBILFRYRESVE

Beograd, 10 nëntor 2015

DEKLARATA E MISIONIT

Përpjekjet e përbashkëta të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile, të mbështetura nga rritja mbështetja e publikut, kanë ndihmuar në rritjen e transparencës dhe integritetit në administratën publike dhe kanë hapur mundësi të reja për të përmirësuar mbrojtje ligjore për bilbilfryrësit. megjithatë, në të gjithë rajonin, bilbilfryrësit vazhdojnë të përballen me hakmarrje dhe kërcënime.

Anëtarët bien dakord se Koalicioni do të punojë në drejtim të forcimit të të drejtave dhe mbrojtjes së bilbilfryrësve, dhe për të përmirësuar kushtet që lejojnë bilbilfryrësit të jenë pjesë e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit. Në mënyrë që bilbilfryrja të shërbejë si një mjet efikas për të forcuar integritetin e politikës dhe të kompanive, si dhe për të shpënë më përpara mirëqeverisjen, Koalicioni bie dakord se bilbilfryrësit që ekspozojnë rastë të keqbërjes në shërbim të interesit të publikut duhet të mbrohen me ligj nga të gjitha format e hakmarrjes.

Koalicioni do të

- **Advokojë për miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës** në vendet përkatëse.
- **Forcojë vetëdijen publike dhe pranimin e bilbilfryrjes**, duke iniciuar fushata publike. Fushatat do të ndikojnë në familjarizimin e bilbilfryrësve të mundshëm në lidhje me kontributin e tyre konstruktiv në një shoqëri të formësuar nga transparenca dhe llogaridhënia.
- **Identifikojë dhe zbusë boshllëqet dhe dobësitë në mbrojtjen e bilbilfryrësve** nëpërmjet monitorimit dhe zbatimit të ligjeve, politikave dhe praktikave. Koalicioni do të funksionojë si një **Komision Rajonal Etike** për mbrojtjen e bilbilfryrësve, duke ndjekur çështje dhe dhënë rekomandime.
- **Do të veprojë si një platformë** për ndarjen e përvojave dhe mësimëve të nxjerra, praktikave më të mira rajonale për ligjet dhe politikat mbi bilbilfryrësit, zhvilluarë strategji dhe të mbështetur interesat e përbashkëta. Koalicioni do krijojë partneritet me grupe të shoqërisë civile dhe aktorë të sektorit publik dhe privat.

Anëtarët e Koalicionit zotohen të kontribuojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin në arritjen e objektivave të përcaktuara në nivel kombëtar dhe rajonal.

Koalicioni do të ketë një koordinator të caktuar për të udhëhequr zhvillimin e projekteve dhe mbledhjen e fondeve, mbështesë iniciativat e anëtarëve, lehtësojë komunikimin mes anëtarëve dhe përfaqësojnë Koalicionin publikisht dhe në forume të ndryshme.

Koalicioni mbetet e hapur për anëtarë të rinj.